

Nga Valbona në Picar

(Në gjurmët e misionit supervizues të Bankës Botërorë në projektin e zhvillimit të burimeve natyrore)

Nga Haki KOLA

Mirdita me dy bashki pronare pyjesh

Pyjet e Dushkut në Gziq duket sikur po ringjallen. Mirditorët me krenari tregojnë atë që kanë arritur, duke marrë pak edhe nga meritat e shirave të fundit që i kanë kthyer dushkajat si livadhe të gjelbëruara e të harlisura. Bashkia e Rrëshenit duket si një rast i vecantë, pasi përveç qytetit, administron edhe shumë fshatra për rreth, fshatra që kanë marrë ditët e fundit në pronësi mbi 6 mijë hektarë pyje, por që pretendojnë se kanë në territorin e tyre mbi 12 mijë hektare. Kryetari i këshillit të Gziqit, duket pak sa i revoltuar, pasi duke qenë mësues në qytet e kryetar në fshat, ka lënë orën e mësimit në qytet e ka ardhur me nxitim për të qenë korrekt, me misionin e Bankës, i cili është vonuar në mbledhjen në Bashki, i ndodhur në mes shpjegimeve nganjëherë të kundërta midis Pyjores, nënkryetarit të Bashkisë e Shoqatave të përdorimit të pyjeve. Të ardhur sa nga Gjermania, Suedia, Holanda e Skocia, Moldavia, Kosova e Tirana, shpesh bëhet e vështirë për të gjetur, nocionin e përbashkët e përkthyesit i duhet kohë të shpjegojë dallimin midis termave Bashki e Komunë, fshatit e qytetit, përdoruesit e pronarit të pyllit, krenarisë për ringjalljen e zvellimin e pyjeve në 10 vjecarin e fundit nga fermerët e mosbesimin e pyjores pasi komunitat e fshatrat nuk kanë njerëz të ditur, për të rritur pyllin. Një fermer shpreh pakënaqësinë për pagesat e vogla për punën që ka bërë në pyllin e tij, ndërsa tregon trasenë e paparë të rrugës drejt Morinës, ku bashkëfshatarët e tij paguhën shumë herë më tepër. Rruga duket sikur ka gllabëruar gjysmën e pyllit të sapongritur, e ka hallakatur sa andej këndeje mijëra metër kub dherash, me një arrogancë që duket se ja jep autoriteti i funksionit që i është ngarkuar, për të bashkuar e zhvilluar shqiptarët. Mirditorët thonë si me shaka, se rruga do të ishte me jetëgjatë, sikur një përmije e vlerës së saj tu jepej fshatarëve për të mbjelle e mirëmbajtur pyllin rreth saj. Kjo i duket llogjike edhe përfaqësuesve të misionit të Bankës, por rruga për të vajtur në vesh të Qeverisë e të fillojë të zbatohet duket më e gjatë se sa ajo e inagurimit të Durrës- Prishtinës.

Kryeziu i Qafës së Malit do shesë kredite karboni

Në Kryezi të Qafës së Malit komunikimi bëhet më i vështirë. Fshatarët kanë marrë përsipër që të zhvillojnë pyjet e të përfitojnë pagesa duke shitur kreditet e karbonit, për të kontribuar në zvogëlimin e ndryshimeve klimatike. Arkadi nga Moldavia ekspert i Bankës për fondin e Biokarbonit, tenton të gjejë kamerën me të cilën ka fiksuar punën e bërë për ringjalljen e pyjeve, si dhe porteret e dy nënave me origjinë katolike, punëtore për të realizuar projektin, që shpjegonin se në kryesi shumicën e pyllit e trashëgonin familjet myslimane, megjithëse ato ishin më të paktat në numër në fshat. Arkadi i provokon nëse do të ishte më mirë sikur edhe familjet e tyre të ishin shëndrruar në myslimane e të merrnin edhe ato më tepër pyll nga perandoria, por ato thonë se nuk e shesin besimin për një cope pyll, ndërsa Ahmeti një pjesëmarrës në projekt, thotë se ai shkon si në kishë e merr pjesë në meshë ashtu edhe në xhami, dhe nuk përton të thotë pjesë si ga Bibla ashtu

edhe Kurani e të shpjegojë se atij i tepron pyll edhe për të mbyllur për te sekuestruar karbon, pasi ndryshe nga zonjat familja e tij trashëgon më tepër. Unë përiqem tu them së më atë ricungim më tepër kanë prishur se kane rregulluar, duke treguar disa pisha te reja te prera e përdorura per hunj, ndërsa zonjat shpjegojnë se „hala „ dmth“pisha“ është shume e keqe pasi mbulon vendin e nuk bën as për tu djegur e as për kullotë. Halat duhen hequr thonë ata, por një roje duhet paguar, pasi gardhi që është vënë duket si dryni i derës së Nastradinit, pasi pylli poshtë është pa gardh, e gjeja e gjallë këpusin filizat e reja, që sapo kanë filluar të rriten. Tekniku i zonës sheh lart nga Laku i Thiut dhe më kërkon tu shpjegoj Gerhardit e Lenartit se atje ka qene pylli i vërtete, ku Gjonit e Prengës u është dashur të punojnë mbi 30 vjet për të prerë. Nën livadhet e bjëshkeve, duket se zjarri ka lënë pak pyll ahu të padjegur si një provë se atje dikur ka qene pylli. Tekniku thotë se burri më i zoti i fshatit nuk mund ta mbajë gishtin e vogël të dorës më shumë se pese sekonda në burimit te Lakut të Thiut, pasi gishti do të paralizohej. Lenarti e Margareta u bënë protagonistë të darkës së organizuar nga Kryetari i komunës së Shënmërisë, pasi ekipi Suedez atë natë shënoi fitoren e parë në European, që Gerhardit e Dritës ju dukej si ogur i mbarë për ndihmat që pyjet shqiptare mund të marrin më tepër mbështetje nga Organizata Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar.

Kruma, ujë dhe vetëm ujë

Të nesërmen Skënderi bashkë me dy agronomët e veterinerin e Bashkisë së Krumës na dhuruan një shpjegim perfekt teknik të mundësive për të realizuar zhvillim të integruar te bujqësisë, blegtorisë, pyje e kullotave, për të shëruar plagët e hapjes pa kriter to tokave të reja në pllajën e Hasit, duke krijuar mundësi për të ndaluar erozionin e shtuar jetën e Hidrocentralit te Fierzës, të cilës Kukësi e Hasi i kanë falur, pjesë ë qënies së tyre. Lenarti duket pak i merakosur, për këmbënguljen ndoshta të tepruar të Skënderit, që para se të investojmë duhet të gjejmë të zotin e tokës, kjo për faktin se objektivi qëndror i projektit është të përkrahë më të varfërit e të patokët në fshat, nëpërmjet mbështetjes së tokave të përbashkëta, por argumenti që kryefjala për zhvillimin e Hasit është uji, uji dhe prap uji, për të gjithë dukej bindës. Në drekën që shoqëroi seminarin, Hasianët e befasuan Gerhardin, zyrtar i lartë i Bankës Botërore në Ëashington, ish drejtues për disa vite të projektit shqiptar të pyjeve, kur në fund të drekës, i sollën tortën me fishkzjarree e me urimin për ditëlindjen e tij të mbi pesëdhjetë që e kish kapur në zonën e tyre. Në rrugën drejt Golajve, një ekspert skocez që sapo i është bashkuar SNV me gjysëm shaka hedh idenë që bunkerët e shumë mund të përdoren pëe të prodhuar qymir druri, nga pemet që hiqen gjatë rrallimit të pyjeve, shaka që futi në debat pothuaj gjithë pjesëtarët e misionit e Lenarti vazhdimisht ngacmohej për këtë funksion të pamenduar të kësaj dhoratës së fundit që i la diktatura popullit e pejsazhit shqiptar!!!!

Golaj kërkon më tepër

Fermerët e Golajt duken si më të familjarizuar me projektin. Ata janë krenarë që në vitin e kaluar kanë shpëtuar pas asnjë zjarr, kanë si të thuash ngritur nga zero e bërë pyje të vërteta në nje kohë rekord në mirëkuptim të plotë me njëri tjetrin mbi 700 hektare pyje, si dhe kanë mbyllur për projektin e karbonit mbi 200 hektarë, në kufirin që i ndan ata nga

Bytici i Tropojës. Ngastrat e dushkut duken vërtet të harlisura, dhe mëdyshjet e mija te tre viteve më parë për të përfshirë edhe disa pyje ku kishin mbetur vetëm disa shkurre me bush të vogël duket se kishin qene pa baza, pasi druret e vegjel të frashërit, arrës e gështenjës, duket se shpejt do ta mbulojnë bushin e do të krijonin pyllin, ashtu sic vendalinjtë, që kishin dalë të na takonin, pothuaj një nga cdo shtëpi, e përipiqeshin të na bindin me krenarinë e bukurisë së vendit e të pyjeve të krijuara prej tyre. Duke pakësuar rreth 200 hektarë mundësine e kullotjes, u shpjegon Gerhardi atyre, ju me dhinë apo lopët tuaja do të kullosni tokat e fshatarëve të tjerë, duke u bërë atyre dy padrejtësi, paksuar kullotën e duke mos ju krijuar mundësi që të përfitojnë as nga paratë e projektit për mbjellje e as nga shitjet e Karbonit. Të gjithë fshatrat aplikuan për projektin e Karbonit, por ajo Italia që erdhi e kontrolli ne vend, i vlerësoi më tepër propozimet tona. Ne kemi mjaft kullotë e nuk dëmtojmë të tjerët, por nëse doni të na ndihmoni na i shtoni projektin e karbonit. Golaj ka 20 mijë hektare e ne mund të mbyllim deri në një mijë argumentonin ata. Në pyjet që na janë përmirësuar, ne mund ti bëjmë për momentin të dyja si kullotjen ashtu edhe rritjen e pyllit. Këtë e kemi bërë tradicionalisht në zabelet tona, e duket se Banka Botërore me SIDËN Suedeze e SNV Hollandeze po na ndihmojnë ta ngjallim prapë këtë traditë të bukur.

Bytici midis zjarreve dhe shpresës

Rruga për në Bytic duket e vështirë, ndërsa dielli ka marrë rrugen e perëndimit. Rruga është hapur e tëra për tu rikonstruktuar nga Golaj në Tropojë, cakulli e bën të vështirë ecjen, shpatet poshtë rrugës janë mbushur plot gurë e dhera, dhinë e delet kapërcejnë për të kullotur mbi gurë të mëdhenj te përhapur kudo, ndërsa një sipërfaqe e pamasë pylli e kullote është djegur në qindra e qindra hektarë. Zjarri ka marrë mbarë poshte e lart rrugës, duke kaluar nga Paci (qendër e komunës) në gjithë fshatrat për rreth, duke hyrë shpesh edhe në brendësi të fshatrave. Fshatarët thonë se zjarri i vitit të kaluar na mundi. Na mundi se ne kishi mbetur pak në fshat dhe ai ishte i paparë, jo vetëm të nxehët i madh, por nxehët e erë e fortë, ne dijmë të kontrollojmë zjarrin që vjen nga poshtë, pasi i hapm koridore e kanale, përdorim edhe ujin, por ky ishte zjarr nga lart e na zhuriti jo vetëm pyjet por nga njëherë edhe bahcet e të mbjellat. Banorët në Byticin e thellë duken shumë të rrallë. Disa nga shtëpitë duken si të pabanuara, catitë muret dritaret avllite e bahcet brenda tyre duken si të mbuluara nga një enigmë e shoqëruar me hijen e braktisjes e të vënies nën sundimin e një bote biologjike paranjerëzore, ku kafshet dhe bmët bashkë me motin, errësirën e lagështirën janë në garë për të zhdukur gjurmët e dikurshme njerëzore. Catitë dhe muret kanë filluar të përkulen. Vende vende kanë filluar të bien.Ndërsa grupi debaton se pylli duhej të ishte rralluar më tepër, Admiri ka vajtur në Bajram Curri, për të parë edhe njëherë për hotel, pasi në qytet zhvillohet një aktivitet ndoshta folklorik si sofra tropojane, me pjesmarrje pothuaj ballkanike, e pjesëmarrja e zonjës së parë të vendit, duket se ka krijuar ngushticë në këtë qytezë deri tani me pak hotel. Ne dijmë si bëhet pylli, na afrohet me nxitimin karakteristik të të ecurit e të të folurit një nga vendasit. As lopës, as deles e as pyllit, nuk u merren të gjitha menjë dorë. Herë duhet tu japësh e herë tu marrësh. Ju pylltarët doni që ta bëni pyllin të bukur e të shëndetshëm, por nga njëherë, ju na harroni, neve njerëzit. E gjithmonë mëndjen tek gjobot e keni. Une di si rrallohet pylli, por ata që pylli mi jep unë i marr kur më duhen, sot dicka për zjarr, nesër për gardh, pasneser për gjeth apo hunj domatesh. Kështu pylli

rrallohet, bari del poshte, gështenjën po e di se duhet lënë për mbarë, po kështu edhe qershinë e eger, por kjo kur më duhen e kur me del koha. Se u prenë nje vit më vonë, apo një vit më parë, pylli është mësuar me mua. Ajo që ju mund të rregulloni e të më këshilloni është për shembull, se cfarë unë kam të drejta të heq nga ky pyll, ta zemë pas 10 vitesh, me një fjalë, kur ju të më kontrolloni, fjala vjen kur të bëni planin e ri, unë të kem për shembull një 50 apo 100 a 20 drurë për dynim. Kjo do ti shkurtonte punë edhe teknikut apo شمارit, që të mos rrijë cdo jave pas meje duke me dhënë damkën për drurin që pres, por fjala vjen të vijë e të shohë se sa unë e kam zbatuar marrëveshjen. Ne e bëjmë më mirë se shteti si pyllin ashtu edhe gjënë e gjallë, pasi ne dijmë nga të parët tonës si të ruajmë farën e pikërisht farën e mirë. Shteti nga njhere sidomos në pyll e humbet farën. Lenarti nxorri kamerën dhe po shihte edhe njeherë dashin e jashtëzakonshëm që po udhetonte me kamion nga Paci drejt kukësit. Trup madh, me kacurrelat e bardhë që i mbulonin qafen e gjate e të paqethur, brirët të trashë me shume përdredhje ai dukej si një qenie hyjnore. Është prej ketu, por po e dërgojmë drejt Lumit të Vlorës, pasi është për mbarë, mezi e gjeti kuptimin e pergjigjes Lenarti. Me një fjalë është dash për farë. Fatosi inxhinieri i ri nga që punon për SIDËN ne Kosovë duket i mërzhitur në rrugën e kthimit ng Bytici në Bajram Curri. Mua më duket kotësi preukopacioni juaj se si të rrallojmë pyllin, në këtë fshat plot me pyje, ku duken tre prioritete, i thotë ai Margaretes ekspertës së Stokholmit për SIDËN, këtu duhet shkolla, rruga e uji. I riu që takova, më shpjegoi se ai ngeli pa shkollë të mesme, pasi për ta bërë duhej të shkonte në Bajram Curri rreth 600 lekë dita vajtje ardhje. Po kështu ngeli edhe motra, të cilën e cuam tek tezja në Puke, e unë punoj që ti paguajmë ato pak cfarë fitoj unë nga ferma për cdo muaj. Ne kemi tokë, por nuk kemi ujë e as treg. Ne kemi blete, por nuk kemi shoqatë dhe nuk marrim këshilla për ti trajtuar apo për të gjetur tregun. Shkolla, rruga e uji ndoshta edhe mund ti kthejnë banoret qe janë larguar thotë Fatosi, ndërsa unë provoj të shpjegoj se në këto zona me shumë pyje e kullota të gjëra ndoshta projekti duhet të jetë më fleksibël dhe të mbështesë fjala vjen, pajtimin e pyllit me dhinë e delen, ndoshta këto dy të fundit po të ishin më të zhvilluara mund ta kishin mbrojtur nga zjarri pyllin e Byticit, por duhet edhe përpunimi i qumështit e mishit apo tregu për këto produkte me shije e pastërti biologjike të pashoqe. Dielli ka perënduar kur arrijmë në qafen që na fal një pamje befasuese, dritat e para të qytetit sapo jane ndezur, ndërsa konturet e Alpeve duken të jashtëzakonëshme. Ah sikur ta kisha për ekranin e kompjuterit thotë Fatosi, ndoshta mund të ishte me e bukura në bote. Por nuk mund ta filmoj pasi duhet bllokuar nje autokollone e tërë, shton Fatosi. Grupi tonë i takoi te flintë në Tropojën e vjetër, pikërisht në një Hotel ne Mejdani, një fshat i bukur, me një luginë të butë plot me livadhe, por edhe ketu me male të djegura, në rrugën e mrekullueshme e të asfaltuar 5-6 kilometer larg pikës kufitare të Gjakovës.

Ne zemren e Alpeve

Ndalesa e parë të nesërmen ishte tek ura e Valbonës, tek kanioni i famshëm i Shoshanit. Cdokush shpejtonte të merrte fotografinë e parë, një nxitim njerëzor i gjithkundshëm, kur has vështrimin e parë në një gjëje të mirë e të rrallë. Lugina e Valbonës duket e mahnitëshme për ata që e shohin për here të parë, jo vetëm ujë i kristaltë që vrapon në shtratin e lumit të trazuar herë pas herë nga rruga në rikonstrucion anës tij, por edhe pishat e rralla te rrobullit majë shkëmbnjve, në majat e maleve për rreth, silueta të

mbinatyrsime, që duket sikur kanë mbirë në shkëmb që të prekin qiellin. Në Dragobi kemi harruar të pyesim për shpellën, pas marramendjes që krijon uji, livadhet, pylli e pejsazhi, thirrjet e Gjonit për fotografi, apo zjarret që herë pas herë kanë kafshuar vitin e kaluar edhe Valbonen. Plani për të vizituar Livadhin e Gjarpërit na dështon, pasi shirat e fundit kanë rrëshqitur një masë të madhe dherash, që kërkon ditë të tëra të riparohet me fadromat që sapo janë nisur. Hotelin që e kisha parë tek hidhte shtat në mesin e viteve 80, e gjetëm të lodhur e si jashtë vendit e kohës. Duket si skeleti i një fantazme që së bashku me bunkerët nuk don të na ndahet, por dikush thotë që mund të kthehet në realitet e ti përshtatet vendit e kohës pasi është privatizuar nga një koleg i yni, i cili ndoshta do të kujdeset për mirëmbajtjen luginës së Valbonës e kësaj perle të Alpeve tona, unikë në madhështinë, dritë hijet e surprizat e pafunda.

Përpiqemi të ngjitemi në një ndër ballkonet që vendosen në luginëzat e shpatmaleve. Pas pak hasim disa pisha të krasitura sikur të ishin dushqe, e debati në mes pylltarësh nuk ka të sosur, përse banoret e alpeve duhet të rrezikojnë jetën e të ngjiten për të prere degët e pariperteriteshme të pishave deri në 15 apo 20 meter lartësi. Une pretendoj se kërkojnë më shumë dritë të arrijë në tokë që toka të bëjë më tepër bar, por duket se jam gabuar. Pak më lart duket një mur i pafund me gurë, të bardhë gëlqerore, i cili është mbuluar i tëri me degët e pishave, të krasitura të hasura më poshtë. E gjithë ana e djathtë e luginës ishte rrethuar për të formuar një livadh malor, të cilit pretendohet ti merret një kosë. Pak bar por aq i domosdoshëm për dimër. Më lart është stani dhe shtëpia sezonale e fermerit. Një shtëpizë modeste, reflektori i dixhitalbit sikur na ngacmon herë pas herë duke na hedhur rezet e diellit. Debate të gjata e plot enigma në marrëdhëniet e malësorëve me kullotën, kanuni, zakonet shtegtimi i gjësë së gjallë, konfliktet e komunave dhe fshatrave të alpeve për pronësinë mbi kullotat e menaxhimin e tyre. Midis ligjit, e traditës, mbetet një hapsirë, një pasuri por edhe një sfidë që duhet trajtuar. Kooperativa i ka përzier pak kufinj të traditave, e të vjetrit duhen shfrytëzuar për t'u kthyer traditës thotë një profesor i fakultetit. Përpara se të gjejmë mekanizmin e bashkëveprimit me blegtorët e alpeve duhet njohur realiteti si dhe mundësitë e formalizimit të marrëdhënieve midis këshillave të fshatrave komunave e blegtorëve.

Përfaqësues nga federatat e Kukësit e Dibrës vijnë nga një vizitë në Pejë e bashkohen në debatin dhe sfidat se si duhet organizuar shërbimi pyjor apo këshillimi i fermereve pas transferimit të pyjeve e kullotave në pronësi të komunave, një seminar fushor, ku debati duket si ndërkombëtar në perlën e Alpeve shqiptare, midis Jezerces, Kollatës, qypit të Gracit e Rupës në veri e verilindje dhe majave të Boshit e Hekurave në jug e juglindje. Gerhardi kërkon që të provojmë të shkojmë drejt qafës së Valbonës për të hedhur vetëm një vështrim mbi bukuritë e lumit të Gashit, luginës së Shalës e të tjera bukurive të alpeve, së paku për të parë nga larg e pasuruar shpirtin me bukuri që rrallë kujt i takon të shohë nga globi ynë i vogël, por një shi i rrëmbyer karakteristik për brendësinë e alpeve, na detyron të shpejtojmë drejt makinave e par ta shoqëruar luginën deri sa ajo ia dorëzon ujin Drinit.

Projektet për pagesa të shërbimeve mjedisore nga HC i Fierzes midis ëndërrës e realitetit

Kishte filluar rruga e kthimit, dhe njëkohësisht e një debati për mundësitë e projekteve të shërbimeve mjedisore për të mbrojtur digën e liqenit të fierzes, rezervuarin e tij por edhe rrugën e urat, nga erozioni e rrëshqitjes që vijne si pasoje e shpyllezimit e zjarreve.

Akoma duken shenjat e një rrëshqitje masive të tokës mbi sallën e maqinerive të Hidrocentralit të Fierzës, i shpjegon Jani kolegut të tij Harkos, ndërsa unë kujtoj takimin e Gerhardit me Ministrin e Ekonomisë dhe Energjistikës në mos gaboj në vitin 2003, në një tentativë të herëshme për ta bindur për një bashkëpunim midis Komunës së Fierzës e Drejtorise së Hidrocentralit apo KESH, që të vishen me pyje shpatet e maleve që i dergojnë ujrat në rezervuarin e Fierzës. KESH harxhon jo pak për çdo vit duke ndërtuar prita malore apo gabione, për të frenuar rrëshqitjen e shpateve apo mbushjen e rezervuarit. Lenarti ka bërë para dy vjetësh një foto aty ky lumi i Gomsiqes bashkohet me rezervuarin e HC të Vaut të Dejes. Në foto janë dy ura, njëra mbi tjetren me diferencë moshe rreth 20 vjet. Lumi e ka ngritur shtratin si rezultat i erozionit në shpatet e maleve dhe ura e vjetër herë pas herë në kohë vërshimesh puthet me pasqyren ujore të lumit. Një urë e re ka hedhur shtat për të bërë të kalueshem lumin. Ashtu si pritat gabionet apo urat e reja janë pasoja të degradimit të tokës, dhe erozionit. Kjo është Fierza u shpjegon Jani Gerhardit e Dritës dhe pritat e ndërtuara për të mbrotjur sallën e makinerive kanë kushtuar thonë rreth 1 milion dollarë. Toka është e pjerrët, mjaft e ndjeshme karshi diellit, ngrices, borës shiut e erës. Vende vende sopata e zarri i kanë zhdukur drurët dhe gërryerjet duken të thella të gjata e agresive. Rruga është plot me makineri që pastrojnë mbushjet nga shpatet, ndërsa mbushja që i bëhet rezervuarit duket e pamatëshme. Fshatrat janë të rrallë, akoma më të rralla shtëpizat e malësoreve si ishuj të vegjël, mbytur në gjelbërim të harlisur, që për të mbijetuar ruajnë pyllin rreth e mbi shtëpi, dhe shfrytëzojnë sa munden si për të kullotur gjënë e gjallë ashtu edhe për të prerë e shitur dru pjesën tjetër. Mjafton të merremi vesh me këta njerëz, që ata të ndryshojnë vendet e kullotjes, apo bashkë me ta të gjejme një zgjidhje, dhe atyre tu japim paratë që sot i harxhojmë për të rindërtuar urën pastruar rrugën e tjera, ndoshta duke përdorur një pjesë edhe për shkollë e shëmbdetsi. Mua më kujtohet ajo që depueti e profesori Rexhep Uka u thoshte bashkëfshatarëve të tij, që mali i përdorur së bashku i ngjan një kooperative të mirë, por në rastin konkret është mirë që secili nga këto baorë të paguhet për kujdesin për të mbyllur një vatër erozioni, kuruar plget e zjarrit apo shtuar mbulesen barishtore.

Drejt mbretërisë së kullotave të Jugut

Pas mesnatës, në Tiranë po planifikonim detajet për pjesën e dytë të udhëtimit drejt Tepelenës, Lopësit, Picarit, Lukoves e Lumit të Vlorës. Gerhardi do të largohej për tu zevendesuar nga Roberti një ekspert me përvojë të gjatë në Bankën Botërore, vecanërisht për kullotat e kullotjen. Edhe grupi shqiptar sikur u thjeshtua, duke synuar më tepër për një grup të vogël që krijon më shumë konfidencë më fermerët e barinjte të jugut. Mbikullotja konsiderohet shpesh si shkaku kryesor i degradimit dhe cveshjes së maleve të jugut. Vlerat e pejsazhit të mrekullueshem të jugut, me vargmale madhështore të kombinuara me luginat e mrekullueshme të Vjosës, Drinos, Shushicës, apo bregu i mahnitshëm i detit Jon, ndoshta do të ishin edhe më të vlerësuara, dhe do të sillnin më shumë të ardhura, nëse do të ndalohej degradimi i bimësisë, ashtu sic ka ndodhur në veri të vendit dhe malet do të visheshin me lisat e gjatë apo me barin e shumëllojshëm. Ndoshta kjo do të ndikonte edhe që të ktheheshin përsëri thëllëzat, zogj e kafshë të tjera, tepër tërheqëse për turistët që të kërkuar për zhvillimin e kësaj pjese të vendit.

Shkencëtarë të huaj dhe të vendit, kohet e fundit shpesh kanë evidentuar që në gjëndjen aktuale kapaciteti i kullotave të jugut ka rënë së tepërmi dhe ata mbajnë aktualisht rreth tre herë me tepër nga sa është kapaciteti natyror aktual i tyre. Problemi duket pak sa delikat, pasi edhe në traditën e lashtë shqiptare të pasqyruar si në Kanunin Lekë Dukagjinit, në atë të Skënderbeut apo Idriz Sulit (Labërisë) asnjëherë nuk gjënden kufizime mbi numrin e blegtorisë që mund të mbajë cdo familje. Bile shkohet më tej kur theksohet se meratë nuk mund të rrethohen e gardhohen. Kjo ndoshta shpjegon edhe faktin që gardhi elektrik aq i përhapur kohët e fundit në kullota në vendet e zhvilluara, në Shqipëri nuk ka qenë i mirëseardhur.

Të gjendur para një realiteti kur shteti shqiptar iu dha komunave të drejtën e pronësisë mbi kullotat, kuptohet që edhe vendim marrja merr më tepër peshë në komuna e fshatra, ku një kombinim i të dhënave shkencore me përvojën historike, mund të sillte një zgjidhje të shpejtë dhe ndoshta me rezultate afatshkurtëra. Dilemat midis uljes së numrit të krerëve, shtimit të kapacitetit, apo vënies së tarifave të shkallëzuara sipas kapacitetit kullor e numrit të krerëve që i takon si mesatare cdo familje nëse konsiderojmë një ndarje vëllazërore janë alternativa që misioni i Bankës kërkon ti konsultojë me drejtues të shërbimit pyjor, shkencëtar si dhe kryetar komuash e cobanë me përvojë.

Lopësi në dilemen midis deleve e dhive, dafinave, lisave e thëllëzave

Pas një vështrimi paraprak të luginës së Vjosës me madhështine e maleve të Lopësit të para nga Krahësi aty ku Mallakastra ndahet me Tepelënen, Ferdini bën një prezantim të hollësishëm të gjetjeve kryesore nga misioni i tij me Francin nga Austria, për format e përdorimit të pyllit nga fermerët shqiptar njëkohësisht si pyll e kullotë, si burim druri, kullotje, baze ushqimore e vendi që mbyllet për tu kuruar pasi është dëmtuar bimësia e ka filluar të gërryhet toka.

Lopësi ka kapacitet të mbajë më shumë blegtori se sa ka aktualisht, e megjithëatë, pyjet mbi kullotën, dafina thuhet është zhdukur, korijet e lisave duken të mbikulltura e të eroduara. Debati me Vaidin, Servetin e Robertin fokusohet në mekanizmat që mund të përdorë, fshati apo komuna, duke caktuar tarifën e kullotjes, e në rastin konkret për shembull ulur tarifën e deleve, për të stimuluar shtimin e saj, pasi sidomos në kushtet e shirave të pranverës së sivjetme, duket që bari është i bollshëm e është më mirë të kullotet se sa të thahet e pastaj të bëhet rrezik zjarri. Nga ana tjetër komuna mund të vendosë për rastin e Lopësit rritjen e tarifave për cdo krere të dhirtë. Në këtë mënyrë fermerët stimulohen të mbarështojnë delen, për të cilat vendi i tyre ofron mundësi për më tepër dhe njëkohësisht të ulin numrin e dhive për të dhënë mundësinë lisave apo dafinave të Lopësit të ringjallen e të zbukurojnë vargmalet. Kjo duket si një traditë e harruar që në luftën botërore, shihet edhe si një frikë nga fermeret, por duket se debati ka filluar e ndoshta zgjidhjet nuk do vonojnë.

Afër ish Hanit të Dragotit, Serveti na tregon pothuaj tërë shpatet malore të Tepelënes, pyjet e kullotat të gjitha të përdorura në kullotë herë në verë e herë në dimër, e më pas grupi i drejtohet komunës së Picarit.

Kullotat mund ti japin mbi 100 mijë dollarë të ardhura në vit Picarit

Picari mban mbi 45 mijë të imta. Cimi, kryetar i komunës propozon që t mos futemi në zyrë, por të nisemi e të shohim nga një pllajë në mes të komunës bukuritë e maleve, pllajave e luginave të Picarit. Drejtoresha e DSHP, bijë e Picarit e përkrah propozimin dhe të gjithëve u jepet mundësia shohin kopetë e deleve të priveligjuara nga lagështia e fillim verës, akoma të pangjitura në malet e larta, e të vazhdojnë debatin e nisur në Tepelenë, për mundësitë që kanë komunat për të menaxhuar më mirë se shteti pasuritë që natyra u ka falur. Roberti pyet për tarifën që aplikohen për cdo kokë dele, dhe kush i mbledh ata. Cimi sqaron se Vendimi i Këshillit të Ministrave, ja ka dhënë të gjitha kullotat tradicionale në pronësi komunës, por akoma dorëzimi i territorit nuk është bërë me procesverbal nga DSHP, kështu që edhe këtë vit të ardhurat do ti grumbullojë shërbimi pyjor. Ai shpjegon se nga 45 mijë të imta që ka Picari mund të mblidhen për cdo cit rreth 100 mijë dollarë, të cilët në vitet në vazhdim do të mbeten në komunë dhe do të përdoren nga komuna, si për punësimin e banorëve, ashtu edhe për përmirësimin në përgjithësi të kapacitetit të kullotave.

Gardhet e para në Picarin e kërcënuar nga tragjedia e të përbashkëtës.

Lenarti ndalet të filmojë një gardh të bërë me gabion në gjatësi mbi një kilometër, një gardh i bukur i qëndisur nga një prej banorëve të kthyer nga kurbeti, për të mbrojtur shkurret prej lisi si dhe barin në kodrën që i kishin lënë trashëgim të parët e tij. Shparthi e Qarri së bashku me Shkozën Panjen e Frashërin duke i patur majat e tyre të mbrojtura nga gojet e bagëtive, kanë hedhur shtat e po i kalojnë dy metër lartësi. Fermeri e ka populluar këtë pyll të vogël me lepuj e kafshë të tjera gjahu, dhe vitin që vjen pret të marrë të ardhurat e para të investimit të tij.

Tek shoh pyllin e rritur brenda gardhit, mendja më shkon se Picari do të kurohet shpejt nga Tragjedia e të përbashkëtës. Gardhi është shenja e parë, që banorët po largohen nga bota virtuale dhe po mendojnë të ndërtojnë të ardhmen e fëmijëve të tyre. Fermerët e Picarit kanë organizuar një javë më parë një vizitë në Fedratën Rajonale të përdoruesve të pyjeve e kullotave të Korçës, për të parë se si i kanë ndarë dhe po i rrisin pyjet fermeret e Liqenasit dhe ato të komunës së Bucimas në Pogradec. Për pyjet e fermerëve të fshatit Peshkëpi, kryetari i shoqatës së përdoruesve të Picarit tha: atje pamë një mrekulli, unë nuk e di se çfarë të them. Unë filloj të kërkoj se mos gjej disa nga kryetarët e fshatrave që të vazhdoj debatin e fillur me ta një ditë para pavarësisë së Kosovës, por nuk dalloj asnjërin prej tyre. Ferdini thotë se secili mund të bëjë zgjidhjen e tij dhe nëse fshatarët e Bucimasit apo Peshkëpisë kanë zgjedhur ruajtjen e pyllit, pasi duan ta bëjnë më të bukur fshatin e tyre, këtu ka më tepër rëndësi mishi e bulmeti, kështu që Picari ka zgjedhur përdorimin e shijimit e të mirave të natyrës së tij, por mua nuk më duket dhe aq bindëse, kur mendoj se ne shqiptarët nuk mund të mbetemi përjetësisht skllever të asj që na fal natyra. Përpiqem të argumentoj, se natyra e Picarit duhet ndihmuar dhe ndihma mund të vijë duke i punuar tokat bujqësore, prodhuar jonxhe e koncentrat, si dhe duke kombinuar atë që na ofron natyra me atë që realizohet me punë djersë e investime. Dikush argumenton se në Picar mungojnë pothuaj tërësisht kanalet ujitëse, dhe kjo është arsyeja që asnjë metër katror tokë e Picarit nuk kultivohet.

Këshilli i komunës mund të vendosë për tarifa të diferencuara sipas numrit të krerëve

E rëndësishme thotë Lenarti është se njerëzit kanë filluar të mendojnë në Picar. Plani i menaxhimit po hartohet, duhen llogaritur gjithë këto të ardhura, mbi njëqindmijë dollarë që do të futen për çdo vit në komunë, të ardhura që më përpara i merrte shteti, tani janë të komunës. Do të duhet që të përgatitet sistemi i kontratave me të gjithë fermerët. Këshilli i komunës përpara se të marrë vendime duhet të konsultohet si me specialistët ashtu edhe me fermeret që i kanë votuar, për të marrë vendime të drejta për të zhvilluar zonën. Ndoshta ndërhyjnë një fermer, ne mund të përdorim tani një pjesë të të ardhurave nga kullotat edhe për të riparuar kanalet ujtitëse e për të prodhuar foragjere apo miser. Koncentrati mund të lehtësojë presionin mbi kullotën e këshu hap pas hapi edhe ne mund ta ndalojmë degradimin. Ndoshta mund të mendojmë edhe për taksa më të larta për tufat e medha, si dhe të ndihmojmë pak të varfërit që kanë më pak dele e përdorin me pak se sa u takon nga kullota e përbashkët.....

Syrit të kaltër po i kthehet shikimi.....

Në buzëmbremje ndërsa i afrohem Sarandës, dikush propozon një ndalesë tek syri i kaltër, një mrekulli e fshehur nën rrëzën jugore të Qafës së Muzinës. Syri i kaltër pësoi një aksident të rëndë në shirat e rrëmbyera të gushtit të vitit 2002, pak ditë pasi Kryeministrat e atëhershëm italian e shqiptar, thotë ish drejtori i ujrave të Sarandës, kishin bërë një vizitë, për të parë nga afër mundësinë e transferimit të ujrave të Bisticës drejt Italisë së jugut. Një vizitë në shtetin Montana të Amerikës rreth 11 vjet më parë unë kisha shpjeguar që edhe Shqipëria ka burime të bukura, dhe ndër më të bukurit është “Syri i kaltër” në jug të vendit. Kjo është interesante më tha një nga profesorët e Universitetit të atij shteti, po çfarë e bën Shqipëria ujin e syrit të kaltër, m pyeti ai? E derdh shpejt e shpejt në detin Jon, pasi ven në lëvizje një HC në afërsi të burimit, përpqiesha ti argumentoja unë, ndërsa ai shpejtoi të më kujtojë etjen e dy vendeve fqinjë, Italisë së Jugut e Greqisë. Sic duket më shkëputit nga mendimet ish drejtori i ujrave të vitit 2002, aktualisht drejtor i pyjeve të Sarandës, ndonjë sy e keq e sëmuri dhe tepër rëndë Syrin e Kaltër, dhe ai shpjegoi më pas përpjekjet që bëri drejtorja e ujrave për të kthyer ujin dhe shikimin syrit të kaltër. Ai ka përsëri pothuajse prurjen e mëparshme të ujit rreth 6000 litër në sekondë. Lenarti e Bobi ngjiten në një fron të ndërtaur në pjesën e sipërme për të parë beben e syrit. Uji del nga poshtë në formën e një pusi të thellë, me përmasat e një lumit të vërtetë, një rryme jashtëzakonisht e madhe me ujë të tejdukshëm, nuanca blu në të blertë e të cilit, vjen nga qielli, bimët anash apo dritë hijet e bimëve, shpatit e paretëve anësore të burimit. Ish drejtori shpjegon se temperatura e tij pothuajse nuk ka luhatur gjatë vitit, si në stinën e ngrohët ashtu edhe në atë të ftohet ajo qëndron ndërmjet 11-13 gradë celsius. Syri i kaltër ka plot vëllezër shpjegojnë me krenari sarandiotët., janë mbi 20 të tillë që përbëjnë burimin e Bisticës. Ka mundësi hamendësojnë ata, që zanafilla e tyre të jetë një liqen shumë i madh nëntokësor që mund të shërbejë si furnizues i përhershëm dhe i rregullt i të gjitha burimeve të Bisticës. Ndoshta ndërhyjnë Duro Alushi inxhinier hidroteknik me përvojë mbi 30 vjetecare, këto ujra mund të përbëjnë drenimin kryesor të krejt masivit karstik të malit të Gjërë dhe të pellgut hidrogeologjik të fushës së Drinos. Sigurisht që këto janë hamendësime, por nëse i referohemi llogjikës, nuk mundet që prurjet e burimeve të Bisticës prej rreth 18 mijë litër në sekondë të sigurohen në sipërfaqen e vogël që i takon mikrobazentit që e ushqen me ujë, pra pellgu i saj hidrogeologjik duhet të jetë më i madh se sa mikrobazeni që sigurisht i dhuron ujrën e tij,

në fakt burimet e Bistricës gjenden 45 m nën nivelin e luginës së Drinos, çfarë të bën të mendosh se ato mbledhin edhe ujrat e masivit të Malit të Gjërë apo të Luginës së Drinos, mbrëmja po afrohet thotë drejtor nehati, prandaj unë mendoj që ta vazhdojmë në makinë shpjegimin dhe të përpiqemi që të arrijmë perëndimin e plotë të diellit në kalanë e Lëkurësit.

Në rivierën shqiptare

Alisteri, Skocezi i sapoardhur si konsulent për pyjet tek SNV, Roberti e Carli ngrihen herët në mëngjes, për të bërë një vizitë të shkurtër në Butrint, duke përdorur si udhërrëfyes, Carlin një ekspert Suedeze, që punon për Bankën Botërore në Tiranë, dhe është pothuaj i shtëpisë në Butrint, pasi përveç projektit tonë ai kontribuon herë pas herë për projektin e menaxhimit të bregdetit.

Një natë më parë kishim bërë një kalim të shkurtër nëpër Sarandë, e cila Lenartit i dukej si një qytet tjetër. Jam i sigurtë se ime shoqe nuk do të pranojë se kjo është Saranda kur të shohë fotografitë. Mbushur me shumëkateshe të dendura, ajo nuk ka asgjë të përbashkët me Sarandën e vitit 1992, që Lenarti e ka vizituar për herë të parë. Në portin e vogël të qytetit, një vapor gjerman ka sjellë dërrasa Suedeze. Kamionë të mëdhenj vazhdojnë të ngarkohen në mesnatë e ti nisin dërrasat e holla për në Gjirokastrë. Edhe në fermën time private pyjore realizoj të tilla prodhime thotë Lenarti, këto ndoshta janë të ndonjërit prej komshinjve të mij. Sikur të ruheshin e mirëadministroheshin pyjet, ndoshta Shqipëria megjithë këtë sipërfaqe të madhe pyjore, edhe mund të eksportonte. Megjithëkëtë lisa të bukur që kanë filluar të rrisin fermerët tanë, unë ëndërroj që Shqipëria për 10 vitet e ardhëshme të bëhet faktor për të prodhuar fuci prej lisi si për verën franceze ashtu edhe Uiskin skocez.

Një plan për të menaxhuar kullotat e Lukovës

Me synimin për të arritur në orën nëntë të mëngjesit në Lukovë, ekspertët e huaj duan edhe të shfrytëzojnë rastin për të parë bregun e poshtëm të Jonit. Në fakt shpjegon gjithë emocione Liljana, një inxhinierë me përvojë që po harton planin e menaxhimit për pyjet e kullotat që ka marrë në pronësi komuna e Lukovës, bregu është i gjatë, midis detit jon dhe këmbëve perëndimore të malit të Cikës, vijuar më këndeje me vargun Konjak Lavan, në fakt bregu fillon tek përroi i bardhë e mbaron në malin e Shëndëllisë, dhe Liljana përpiqet që ta tregojë edhe në hartën topografikë që do ta përdorë për të vendosur kufinjte e pyjeve dhe kullotave që qeveria i ka dhënë në pronësi fshatrave të komunës Lukovë. Sofoja, një ekspert vendas për kullotat pyet se si do të bëhet për Kakomenë, tani që pylli e kullota është pronë e fshatit, por në përpiqemi që ta mbyllim debatin e Liljana shpjegon se bregu përbehet nga ai i sipërm që përbën pak a shumë Bashkinë e Himarës dhe nga i poshtmi që përfshin që nga Nivicë- Bubari e deri në Borsh, pothuaj tërë komunën e Lukovës. Bregu mund të themi se është një pasuri e mrekullueshme e Shqipërisë si nga njerëzit, trashëgimia etnografike e kulturore, klima toka, bimët e kafshët, hidrografinë e pejsazhin. Relievi i bregut të poshtëm, për ku ne jemi drejtuar është më i butë, që reflektohet edhe tek njerëzit, bimët e jetesa. Por krahas mrekullive të pejsazhit midis detit të kristaltë e të pamatë e maleve shkmbore, edhe degradimi i bimësisë erozioni e zjarret mbeten problem i madh, dhe Liljana më nxit që të paraqes në projektor jo vetëm bukuritë,

që ka filmuar që nga helikopteri Jamarbëri, por edhe pamjet nga rrëshqitjet masive në Borsh e Lukovë.

Vija bregdetare e Bregut ndërhyt Feruzi, pjestar i firmës konsulente është në total rreth 90 km e gjatë, me gjarpërimet e saj ajo është me e bukura e Jonit, me kontraste, plot gjire të vogla e kepa shkëmborë, mjaft abrazive e lartë e dhe e thepisur. Nga gryka e përroit të Borshit deri në atë të Hundëcovës, gërryerjet e shpateve kanë krijuar kone gjigande me mbushjet që i sjellin përrrenjte torenciale, nga kullotat dhe shkurret e degraduara në shpate. Unë përpqem të zgjedh midis pamjeve të shumta duke ndryshuar vazhdimisht disqet për të ilustruar nëpërmjet pamjeve dhe dhënë në kohë sa më të shkurtër kompleksitetin e problemeve, që vijnë si pasojë e mbikullotjes, zjarreve, brishtësisë së ekosistemit, dhe tekave të tokës, ujit, ajrit e diellit

Deti i ngrohet Jonian dhe vargmalet që e ndajnë nga pjesa e brendëshme e vendit krijojnë një klimë tipika mesdhetare, me nje vegjetacion sikur i afroresh tropikut, me temperature mesatare të shkurtit mbi 10 gradë celsius. Sic duket kjo ngrohtësi krijon edhe degradimin ndërhyt Roberti që tashme është kthyer nga Butrinti, pasi delet, dhitë dhe lopët qëndrojnë e kullosin në cdo ditë të vitit, nga njëherë edhe natën, duke mos i lënë kohë bimëve qoftë edhe një orë që të rriten. Dhe kjo që përpara Odisesë, apo Qezarit ndërhyt me shaka Samiu, eksperti i kullotave në projekt. Relievi dhe klima i kanë krijuar mundësi këtij rajoni që bimeë të mund të rriten në të 365 ditët e vitit. Edhe reshjet nuk kanë të reshtur, e kjo vjen nga fakti thotë Mevlani, drejtues i grupit konsulent, që në ekip ka edhe të birin, që erërat e lagështa perëndimore përplasen mbi shpatet e maleve, ku avujt në Lukovë shëndrrohen në mbi 1370 mm shi, të cilat bien mi 80% gjatë vjeshtës e dimrit, dhe me një intensitet ndonjëherë edhe 300 mm në 24 orë.

Nënkryetar i komunës, inxhinier ndërtimi, por që ja din huqet dhe vlerat vendit të tij me logjikë e optimizëm për të ardhmen e Lukovës, tregon për burimet e pasura ujore, sidomos në kontaktet e formacioneve gëlqerore me ato terrigjene, burimet janë të pasura e të bukura vecanërisht ato të Borshit që kalojnë nën lokal (Izvori), apo Sopotit i Borshit, të Bunecit e Lukovës të cilët ndikojnë që të qëndrojnë e gjelbër pjesa e poshtëme e bregut.

Agavia, kryetare e gjëmbacëve te jugut

Makja medhetare, thotë Liljana, ketu është e pasur në lloje dhe në vendet me lagështirë është e harlisur, plot me xinë, mare, mersinë, shqopë, mretë e oleandër, dafinë e gjineshter, ashe e ilqe. Të rralla për Shqipërin janë xhixhibanozi e pambuku i eger, por më i vecanti është rryelli, që është ndoshta i vetmi dru në shqipëri që vegjeton në dimër dhe rrëzon gjethet në verë. Po kështu fiku i detit. Edhe bananja, që dikur bënte vetëm lule, ndërsa ndoshta nga ngrohja globale, ka filluar ta rrisë më tepër frutin. Limoni, portokalli e ulliri, ndjehen më tepër se në shtëpi, pasi janë realisht më të mirët.

Valanidhi është simboli dhe krenaria e bregut. Po shtohet me shpejtësi Selvia, thotë, Ervini, më i riu në ekip, ndërsa Jani shton me shaka se ndoshta është i vetmi lloj pyjor që dhitë nuk e pëlqejnë e për pasojë nuk ia presin kokën. Ja kemi se po na shtohet edhe Agavia, thotë një fermer nga Saso, që na e kanë sjellë nuk e di se nga ku, sikur të mos na mjaftonin gjëmbacët tane, por e di unë zjarrin don ajo, kam frikë se po na heq Valanidhin e Ilqen tonë, nëse do ta lemë, lëre barin se e zhdok për fare. Në disa shpate të duket sikur të jesh në shkretirat e mëdha të Meksikës e jo në bregun e ngushtë e të voglë të Jonit, që edhe pa Agavet ndjehet mjaft i ngushtë për të mbajtur bimët njerëzit e

kafshët.... Robertit i kujtohet debati për gjembacët në kullotat e Picarit dhe këshilla për të grumbulluar sa më shumë gomerë për ti ngrënë e rivendosur ekuilibrin në kullota. Edhe shkurreve me gjemba ndoshta mund tju gjendet ilaci, duke i vënë nga pas e mos ja ndarë një tufë me dhi, por cti bësh Agaves që e kane sjellë njerëzit???. Pikërisht në këtë ekosistem brilant, që të ngjan sikur je në kërthizën e botës. Bregdet i kërkuar nga gjithë perandoritë e perandorët e botës, që nga Grekët, Romakët, Venecianët, Turqit, Rusët, djepi i legjendave, zotave e perëndive të vjetra sa bota është. Të banosh e të menaxhosh këtë ekosistem, sa të bukur e me thesare, aq të brishtë e idhnak, të kërkuar, e që do vizitohet nga pretendente të rinj e të vjetër, kërkon dije e përgjegjesi, kërkon ti njohësh e kapërcesh udhezuesit e rregulloret, të kesh njohje mbi cdo gjë të përparuar në vende të ngjashme, e të synosh largimin nga mbështetja vetëm tek ajo që natyra ofron, të mbështeten njerëzit e ditur e të hapen shkolla për të mësuar se si duhet të bashkëpveprojnë banorët e bregut ne mjedisin rreth tyre, me këtë perlë të mesdheut, të bëhen koshient, që ata jetojnë në një mjedis delikat, që në asnjë mënyrë nuk mund të jetë vetëm një kullotë, që digjet periodikisht, e që të gjithë deri dje kanë luajtur si struci, pasi nuk dihej kush ishte pronari, përdoruesit apo perfituesi, e zjarri zgjidhej si me e lehta zgjidhje.....

Në fillim të mbledhjes, Nehati njofton se sipërfaqja që Këshilli i Ministrave i ka dhënë në pronësi Lukovës është mbi 6000 hektarë, debati vazhdon për rregullimi me kontrata të marrëdhënieve me fermerët si brenda e jashtë Lukovës. Prioriteti jonë është turizmi thotë nënkryetari i Komunës, ndërsa pejsazhi, blegtoria dhe uji e pemët janë shtyllat kryesore të tij. Ndoshta edhe përpunimi si dhe rekalma e produkteve blegtorale të kullotës së Lukovës mund të bëhen faktorë për shtimin e vleres ashtu si është bërë për vajin e ullirit. Rrugës për në Borsh dëgjohet një gurgullime e madhe uji, janë dillgët them unë, por Sofoja nga Corre tregon daljen e tunelit te hapur ndoshta tridhjetë vjet më parë, që e sjell ujin nëpërmjet tunelit 734 metër të gjatë që cau malin nga Tatzati, dhe rrembeu gjithë lumin e kalasës në fshatin Tatzatit për ta shpërndarë nga qafa e gjashtës e deri në Borsh, për të ujitur agrumet e Lukoves.

Roberti ngul këmbë, që përpara se të pranohen ndërhyrjet e propozuara nga projekti e të financohen ata, duhet bërë një analizë ekonomike, për leverdinë të themi të ndërtimit të lerës, shkuljes së barërave të këqia apo plehërimit të kullotës. Prenga ndërhyrës se ka vite që kërkohet por në fakt, pothuaj asnjëherë nuk bëhet. Tirana ka mbajtur përsëri shumë nga kullotat tona, megjithëse neve ato nuk na teprojnë thotë një nga banorët, e Harko nga Holanda, pyet nëse shteti vazhdon të mbarështojë, blëgtori e të mbajë tufa e nëse jo përse duhet të mbajë në pronësi kullota, pasi kullotat duhet ti mbajnë e të mësojnë ti menaxhojnë ata që mbarështojnë edhe blegtorinë..

Nisemi drejt luginës së Borshit, për tui drejtuar qafës së dërrasës, që e ndan Kucin nga Bregu. Ngjitemi drejt Corres e provojmë të shohi edhe njëhere bregun, plot më shkëmbenj, me zallin e depozituar që ka formuar plazhet mahnitëse të Borshit, Jlës, Gjipese e Lukovës. Plazhe si margaritarë të vegjel, si foleza të një bregu plot kepa, gjire e gremina. Pasqyra e Jonit, reflekton hera pas herë diellin shpateve të Fterës e Cores, uji i tij i kaltër i thellë, pothuaj i tejdukshëm, është në mëdyshje për diellin, tja dërgojë rrezet në fund të tij apo tu japë edhe një dorë shpateve. Bregu është një parajsë. Ka bukuri e pasuri. Bregu, Delvina, gjithë fushat, fushëzat për rreth, malet luginat e kodrinat, që të bëhen më të bukura, duhen trajtuar së bashku, që secili të luajë rolin e tij, si deti, mali,

fusha e të gjithë së bashku ti shërbejnë njëri tjetrit për misrin, grurin, peshkun , gjethin barin e secila të shfrytëzohet me masë.

Këmborët e Kucit bien në Stokholm

Rrugën e vjetër drejt qafës së dërrasës e kisha bërë disa herë në vitin 1985, ndërsa studjohej mundësia për tu zgjeruar masivi me agrume i Lukovës, ndërsa Sofoja na thotë të futemi në rrugëne re nëpër luginë drejt fshatit Corre, pas rruga është më e mire dhe e shkurtër. Sofoja na kujton se ndodhemi në grykën e Bodarit, një kanion shumë i thellë midis kodrës së Sopotit (Kalaja e Borshit) dhe skajit jugor të Vakajve, me thellësi rreth 300 meter. Makinat sikur zvarriten rrugës me gropa , në fundin e luginës së rrethuar nga malet e Gjeshnikoshit e Galishtit në lindje dhe atij të vakajve në perëndim, në një gjatësi prej 15 km, dhe në qafën e dërrasës në lartësinë rreth 640 metër ndahemi nga Bregu për tu futur në malësitë e Kucit, që i mbedhin ujrën në luginën e Shushicës e dyta pas Drinos që ushqejnë lumin e Vjosës. Lugina sikur ndan nga lindja malësinë e Kurveleshit, që i jemi afruar së tepërmi në Tepelenë, me vargun malor të Cikë Lungarës një mur që e pengon luginën e shushicës të shohë e përfitojë nga avantazhet që mund ti jepte deti Jon. Në krah të buronjave, burimet kryeore që ushqejnë lumin e Vlorës, është vendosur fshati Kuc, ku ndalemi për të provuar prrijen dhe traditat në gatim të Kuciotëve.

Lokali i befason vizitorët, jo vetm për gaimin e mrekullueshëm të qëngjijt me hell, por edhe për organizimin tepër të vecantë të lokalit, një nga të shumtët në qendrën modeste të fshatit. Loklai ishte edhe banak e dyqan për fshatin e njekohesisht një muze i vogël por shumë i pasur, me hartën e Shqipërisë e të Kucit në oxhak, me rakinë e zverdhur duke u fërkuar me paretët aromë këndeshme të fucisë shumë të bukur me dru lisi, më këmborët, zilet, veshjet e ornamentet e kuzhinës, të vendosura me shumë shije në fund të lokalit. Arsistelit skocez, voza e lisit i kujton traditën e vendit të tij për prodhimin e uiskit, ku kushti kryesor është që alkooli të rrijë me aromën e drurit të dushkut, ndërsa bulemti sikur kishte akumuluar më të mirën e luleve e aromva të kullotave të maleve.

Lenarti kërkon me ndrojtje që të blejë për të dërguar ne Suedi, këmborën e madhe më një tingull të vecantë, simbol të tufave të mëdha me të imta të Kucit e Labërisë, të cilën kërkon tja bashkojë dashit të bukur të Buticit, ndërsa shumë të tjerë blenë nga një mostër të “Ëiskit” të Kucit.

Horë-Vranishti shkollë për pyjet e kullotat komunale na Labëri

Kemi kërkuar të marrim 19 mijë hektarë pyje e kullota, që ndodhen në kufinj të tonë administrativë, thotë kryetarja e komunës, pas mirëseardhes në HorëVranisht, por deri tani në janë ligjëruar vetëm ata, që kishim planin e mbarështrimit, që patëm bërë me mbështetjen e projektit të parë të Banks Botërore. Nëse na jepet gjithë sipërfaqja vazhon ajo, ndoshta mund të shmanget edhe degradimi nga mbi kullotja, pasi HorëVranishti nuk ka më shumë se 20 mijë të imta, dhe në vitet e fundit kemi bërë punë intensive me fermeret për të gjallëruar bimësinë tejet të degraduar të pyjeve dhe kullotave në krahinën tonë.

Relievi i vecantë influencon edhe për një klimë speciale në gjithë krahinën e lumit të Vlorës, ku temperatura mesatare vjetore është rreth 14.5 gradë celsius, ndërsa reshjet arrijnë deri në 2400 mm në vit. Luginës i qëndron mbi krye si ombrellë mali i Cikës,

2045 meter apo më i larti i Bregut, që qëndron si një far i lartë për detin Jon dhe si strehe verore për delet e blegtoret e lumit të Vlorës. Qafa e Shëngjergjit, rreth 800 metër poshtë majës, duket si e vetmja portë natyrore për tu lidhur me Dukatin e bregun. Një tunel në atë drejtim do ti shtonte frymemarjen lumit të Vlorës, por edhe Bregut do ti ulte presionin njerëzor e do ta bënte më atraktiv, pasi do ti shtonte krahas detit edhe malin e nje pejsazh e tradite të papërsëritëshme jetësore cdo vizitori. Mendja me vehte tek thënia e Fatosit të Sidës, se sa e vogël do të nda duket Shqipëria, kur të bëhet me rrugë të rregullta, sa afër do duket, Tërbaci më Dukatin, Dhërmiun, Pilurin apo Himarën. Unë hamendësoj se si do dukeshin malet e Lbaërisë të veshura nga pyjet, më të mëdhenj apo

Vitet e fundit përroi i Kaurrit pranë Tërbacit apo ai i Vranisjtit që derdhen në Shushicë, sikur kanë filluar të bëhen më të qetë. Bari shkurret e drurët po i mbushin gradualisht shpatet e anës tonë thotë kryetarja, kjo edhe falë punës me komunitetin e bindjes se pylli e kullota janë mbështetja kryesore për jetën e përditëshme të fermerit. Por përrenjtë perëndimorë bëhen cdo vit e më agresive. Përrenjte zbresin në terrene tektonike shumë të pjerrëta. Ato janë të shpeshtë e agresivë duke e prerë shpesh e shpesh malin që nga maja deri në det, që nga përroi i Gërzhinës, Dukatit, i rrugëve të bardha, i Dhërmiut, Ngjipesë, Vishës, Spiles e të tjerë, që tërë vitin duken të thatë e të shkretë, e në kohë shirash, cajnë thellë shpatet shkëmbore, duke përcjellë në vend të turbullirës gurë e shkëmbenj drejt rrugëve, fshatrave e detit, me shtretër të mbushur plot me gure të mëdhenj nganjëherë disa tonësh. Shkatërrojnë rrugë, kullota e ara, por ndonjëherë krijojnë edhe plazhe zallore.

Urën e Tërbacit e kalojmë me frikë, pasi duket si e sajuar mbi disa shina, ku pllakat metalike rrëshqesin lirisht, e gomat sikur do depertojë për ti përcjelle makinat në hone pabesueshmërisht të thellë të krijuar nga përroi karstik. Përballë në anën tjetër, ka mbetur i papërfunduar, pallati i kulurës së Tërbacit i nisur që para viteve 90, që dikush me shaka thotë se mund ta kthejmë në një dyqan relikash përse jo edhe këmborësh e ziles për turistë” tekanjozë”

Pylli i Tërbacit është kthyer në një ‘livadh’ me bimësi plot shëndet, e kryetarja ndjehet më krenare se sa me qenë nga Kuci, kur tregon se Banoret e komunës së saj janë të zotë të mbajna fjalën e ta zbukurojnë Tërbacin dhe gjithë Horë Vranishtin. Robeti pyet se çfarë është bërë, dhe Fori, inxhinieri që e ka asiastuar shoqatën, bashkë me Abdylin, pika fokale e projektit për Vlorën, shpjegojnë, teknologjinë e zbatuar, duke prerë rrafsh të gjithë shkurret e dushkur, të kullotura për vite, nga dhitë e delet, të deformatuara, ku rrugët e transportimit të ushqimit nga toka në gjethë i kane bllokuar, gungat e kthesat e tepërta. Filizat e reja duken të shëndetëshme e premtuese. Nëse Horë Vranishti do të vazhdojë në rrugën e nisur, duke llogaritur kapacitetin e kullotës, hartuar kalendarin e kullotjes për cdo vend, diferencuar tarifat, duke taksuar më tepër ata që kanë tufë të mëdha e i përdorin për fitime e shitje, ndërsa duke i stimuluar fshatarët e varfër, që kanë pak tokë bujqësore, që te mbajnë më shumë dele dhe e lopë duke paguar tarifa më të ulta, por duke gjetur edhe mënyra për të shtuar gjahun si thëllëzën, pëllumbin, fazanin, lepurin e të tjerë, lumi i Vlorës mund të bëhet një shkollë edhe për gjithë komunat e bashkitë e bregut të detit Jon dhe po kështu për gjithë Labërinë.

Dhënia në pronësi e pyjeve dhe kullotave, fshatrave dhe komunave, krijon mundësi të gjëra për të zgjuar traditën dhe mëndjen e njerëzve, që fermerët të kërkojnë krahas kthimit në traditë, edhe dijen, për të përfituar në maksimum, nga përvojat më të mira të

botës së zhvilluar, duke hapur shkollat si për kullotjen ashtu edhe përpëunimin e produkteve të saj mishit e bulmetit, bimëve mjekësore apo shtimit e përfitimit nga gjahu e turizmi.

Misioni i Bankës dhe Ministri i Mjedisit ishin pothuaj në një mendje që numri i komunave që mbështeten nga projekti në Jug duhen shtuar, duke futur të parën në listë atë të Zagorisë, më kryetare Anastasine, konkurente e kryetares së Horë Vranishtit e duke vazhduar me Kurveleshin, Pogonin, Luftinjën, Xarën, Dropullin, Livadhjanë e Orikumin. Duket se pejsazhi i maleve te cveshura të jugut do të fillojë nje ndryshim të ngadaltë, por të qëndrueshëm, banorët do të mësojnë ta përdorin më mirë dhe ta kthejnë në një parajsë të vërtete me bar e pemë, plot me gjah e turistëb, ku erozioni të kujtohet si nje fenomen i dikurshëm.